



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

NJOFTIM PUBLIK

Në kuadër të mbështetjes për përfitimin e kredisë së lehtësuar për strehim, për të punësuarit përfitues, në varësi të Ministrisë së Arsimit, për vitin 2026, ju bëjmë me dije se bazuar në Ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimin nr. 468, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës” dhe në Vendimin nr. 492, datë 26.6.2026 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike, për **vitin 2026**”, për Ministrinë e Arsimit (MA) janë miratuar **70 kuota** për trajtimin me kredi të lehtësuar, për të punësuarit përfitues, në varësi të Ministrisë së Arsimit, për vitin 2026.

Ftohen të gjithë të interesuarit të aplikojnë nëpërmjet portalit *e-Albania*, nga data 27 gusht 2026 deri më datë 25 shtator 2026, në linkun më poshtë:

<https://e-albania.al/ServiceDetails/15809>

Përfituesit përzgjidhen nga Komisioni i Vlerësimit, i ngritur pranë Ministrisë së Arsimit në bazë të sistemit të pikëzimit, të përcaktuar në vendimin nr. 468, datë 26.7.2023 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me kredi të lehtësuar të të punësuarve në administratën publike për blerjen e banesës”, brenda **10 ditë pune** nga afati i mbylljes së aplikimeve.

SHTOJCA 1: KRITERET E PIKËZIMIT

	KRITERET E PIKËZIMIT	100 pikë
1.1	Kushtet e strehimit	50
A.	Nuk disponon banesë në pronësi (Vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të tij/saj dhe anëtarëve të familjes së tij, sipas certifikatës familjare, si dhe të bashkëjetuesit/es, që nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar ose në proces regjistrimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë)	20
B.	Banojnë në banesa në rrezik shembjeje, kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore	5
C.	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi	5
Ç.	Familjet që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose e zbatimit të një vendimi gjyqësor	10
D.	Banojnë në banesa, që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike	10
1.2	Kushtet familjare/sociale/punësimi	25

A	Punonjësit arsimorë, të cilët, në momentin e aplikimit, janë të punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar	5
B.	Familjet, ku të dy bashkëshortët (martesë e lidhur përpara nëpunësit të gjendjes civile) janë punonjës arsimorë	10
C.	Punon jashtë vendbanimit mbi 100 kilometra larg dhe që qëndron në njësinë e vetëqeverisjes vendore (bashkisë), ku ndodhet institucioni publik i arsimit parauniversitar ku punon	10
1.3	Kushtet ekonomike	25
A.	U përkasin kategorive të përcaktuara në lidhjen nr. 1, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar	10
A.1	U përkasin kategorive të përcaktuara në lidhjen nr. 2, të vendimit nr. 425, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar	15

SHTOJCA 2: KRITERET E PIKËZIMIT NË RAST TË BARAZIMIT TË PIKËVE

KRITERET E PIKËZIMIT NË RAST TË BARAZIMIT TË PIKËVE		50 pikë
1	KUSHTET FAMILJARE/SOCIALE	40
A	Punonjës, i cili punon jashtë vendbanimit mbi 100 kilometra larg (sipas distancave të miratuara me urdhrin nr. 48, datë 7.4.2023, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e distancave kilometrike ndërmjet qyteteve të Republikës së Shqipërisë dhe hartës së përditësuar të rrjetit rrugor kombëtar”) që qëndron në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ndodhet institucioni publik i arsimit parauniversitar, ku punon.	15
B	Çifte të reja ose familje një prindërore me moshë jo më të madhe se 35 vjeç (Familje te reja ku çifti bashkëshortëve ka moshë të përbashkët totale deri 70 vjeç.)	10
C	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë ku përfshihen dhe vajzat nëna	5
Ç	Përbëhen nga familje që kanë në ngarkim persona me aftësi të kufizuar apo persona në pension.	5
D	Familjet me më shumë se katër fëmijë	5
1.2	KUSHTET EKONOMIKE	10
A	Të paturit pasuri të luajtshme në pronësi, me vlerë nën 1/4 e shumës së vlerës përkatëse të banesës, për të cilën do të përfitojë kredi të lehtësuar	4
B	Të paturit pasuri të luajtshme në pronësi, me vlerë nën 1/8 e shumës së vlerës përkatëse të banesës, për të cilën do të përfitojë kredi të lehtësuar	6

Në rast se rezultojnë më shumë kandidatë me pikë të barabarta sesa kuotat e përcaktuara në vendimin 492, datë 26.6.2026 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kuotave të përgjithshme të kredive të reja për kategoritë prioritare të të punësuarve përfitues në administratën publike, për **vitin 2026**”, përzgjedhja e tyre do të realizohet me short të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit duke siguruar edhe filmimin e procesit, i cili dokumentohet në formatin elektronik CD, shoqëruar me procesverbalin përkatës.